



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:246260

Datë: 21.06.2023

Numri i dokumentit: 04515317

C.nr.1595/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. S., nga fshati L., Komuna e Obiliqit, përfaqësuar me autorizim nga Z. K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B. K., jurist tek e paditura, me objekt kontesti kompensim i dëmit për shkak të mos-shfrytëzimit të paluajtshmërisë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të datës 05.06.2023 ku prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me datë 21.06.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PATHEMELTË kërkesëpadia e paditësit S. S., nga fshati L., Komuna e Obiliqit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të pamundësisë së shfrytëzimit të paluajtshmërive-njësitë kadastrale P-72614044-00309-0 në sipërfaqe prej 0.26.24 ha, t'ia kompensoj paditësit shumën e përgjithshme prej 4,158.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e parashtrimit të padisë dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,036.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurës, me objekt të kontestit si në hyrje të këtij aktgjykimi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të pamundësisë së shfrytëzimit të paluajtshëmive-njësitë kadastrale P-72614044-00309-0 në sipërfaqe prej 0.26.24 ha, t'ia kompensoj paditësit shumën e përgjithshme prej 4,158.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e parashtrimit të padisë dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,036.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

I autorizuari i paditësit, në seancat e mbajtura dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se përkitazi me kërkesën e të paditurës nr. 6135 të datës 11.08.2021, me të cilën kërkon bartjen e patundshmërisë kinse të eksproprijuar theksoj: me dispozitën e nenit 361 të LMD-së parashihet kërkesat e vërtetuar nga gjykata ose organet të tjera kompetente, në rastin konkret siç pretendon e paditura organet administrative, të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, parashkruhen për 10 vit madje edhe ato për të cilat ligji parashikon afat më të shkurtet për parashkrim. Sipas ligjit nr. 03/L – 154 për pronësinë edhe të drejtat të tjera sendore nenin 295 par. 3 parashihet : “ në qoftese është i nevojshëm një regjistrim për pronat e paluajtshme sipas dispozitave të cilat vlejné në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, atëherë kërkesa për regjistrim duhet të paraqitet brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”. Nga këto dispozita ligjore shifet se edhe shume kërkesa për përsëritjen e të paditurës për bartjen e pronësisë do të refuzohen si të kunderligjeshme. Nga provat të cilat gjenden në shkresa të lendes vërtetohet se e paditura e ka eksproprijuar vetëm një pjesë të ngastrës kadastrale në pronësi të paditësit, praj 7 ari edhe ajo pjesë është bartur edhe regjistruar në pronësi të të paditurës, këtë fakt na e vërteton ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë i cili në raportin e tij pa mëdyshje vërteton faktin se eksproprijimi i kryer nga e paditura nuk e përfshinë pjesën për të cilën e paditura në mënyrë të kunderlisheshme të përsëritur e kërkon bartjen e pronësisë pran kuvendit komunal disa here me radhë por pa sukses. Saj përket lartësisë së dëmit që i është shkaktuar paditësit me pengim të

shfrytëzimit të pronës së tije nga raporti i ekspertit të bujqësisë vërtetohet se paditësit është i dëmtuar për shumën prej 4.158,00 euro, prandaj në këtë rast gjykatës ja paraqes parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë në drejtim të lartësisë së shumës për të cilën e theksova më lartë, të cilën ja dorëzon gjykatës edhe tq autorizuari të palës paditëse. Po ashtu me këtë rast paraqes specifikacionin e shpenzimeve të procedurës, andaj i propozoj gjykatës që të miratoj kërkesëpadisë e paditësit si të bazuar dhe të obligoj të paditurën që të kompensoi dëmin e shkaktuar, duke e penguar paditësin në shfrytëzimin e paluajtshmeris së tij.

Ka kërkuar shpenzimet sipas specifikimit të parashtruar në gjykatë.

I autorizuari i të paditurës, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza juridike ashtu edhe për nga lartësia e saj. Ka shtuar se në këtë kontest gjyqësor u vërtetua se pronar legjitim dhe faktik i parcelave kontestuese të cilat janë objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor është KEK sh.a në baze të vendimeve të eksproprijimit të cilat i kemi cekur gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor. Eksperti i gjeodezisë konstaton edhe vërteton që parcela kontestuese nuk është 39-0 por është e parcelizuar në 309-1 edhe 309-2, ku për 309-2 vërteton se është në emër të të paditurës KEK sh.a ku edhe kalon shiriti transportues i thëngjillit. Këtë e ka paraqitur edhe në skicimin e ekspertizës së tij. Ndërsa 309-1 është në posedim faktik të KEK sh.a në bazë të vendimeve të eksproprijimit, por ritheksojmë që nuk është faji i të paditurës për mos bartje të kësaj patundshmërisë për shkak se sipas vendimit të eksproprijimit organi shpronësues ka qen i detyruar ta zbatoj vendimin e tije duke e bartur këtë pjesë të kësaj parcele në emër të të paditurës. Gjithashtu edhe në bazë të dispozitave të LMD-së ne jemi në posedim faktik të tërësisht të parcelës 309-2 edhe 309-1, për më shumë se 20 vite. Andaj në bazë të deklarimeve provave të sjella në gjykatë si edhe ekspertizës të gjeodezisë kërkojmë nga gjykata që padisë edhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj të tërësi si të pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.04.2022 ka bërë administrimin e provave si vijim: aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë Nr. LRP- 78215 me nr. reference LRP-32215 e datës 27.04.2015, kërkesa e të paditurës drejtuar Komunës së Obiliqit për bartjen e pronësisë, aktvendimi i datës 03.05.1979 nr. 464-34, aktvendimi nr. 465-44 / 80 i datës 30.05.1980, ekspertiza nga lemia e gjeodezisë, dhe ekspertiza nga lemia e bujqësisë.

Gjykata, pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të Nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë në prova dhe ligj dhe si e tillë edhe është refuzuar.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se ngastrat kadastrale 0 objekt i këtij kontesti evidentohen në emër të paditësit. Po ashtu nuk është kontestues fakti për ngastra e lartë cituara është nxjerrë Vendim për shpronësim në interes të të paditurës në vitin 1980, dhe që nga ajo kohë, këto ngastra kadastrale janë në posedim dhe shfrytëzim nga e paditura.

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse është fakti nëse e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit si rezultat i posedimit të ngastrës kontestuese, kjo pasi që paditësi pretendon se nuk ka mundur të realizoj fitim për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të pronave në emër të tij, ndërsa sipas të paditurës, prona kontestuese është të shpronësuar në emër të saj ashtu që e paditura nuk mund të kompensoj dëm për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale pronë e saj.

Nga provat që u administruar në shqyrtimin kryesor gjykatës i rezultoi të jetë e provuar se ne mesin e ngastrave kadastrale të cilat janë shpronësuar nga ana e Komunës së Prishtinës, sipas propozimit të OBPB-së Elektronomia e Kosovës (tani KEK), është edhe ngastra kadastrale objekt i këtij kontesti, që në atë kohë është evidentuar në emër të N. S., paraardhës i paditësit.

Tutje, gjykata gjeti se paditësi si trashëgimtar ligjor i të ndjerit N. S. ndër tjerash është shpallur pronar i ngastrës kadastrale nr. ..., ne sipërfaqe prej 0,26.24 ha, sipas aktvendimit për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore ..., nr. ref LRP-322/2015, të datës 27.04.2015

Gjithashtu, gjykata gjeti se e paditura ka paraqitur kërkesë për bartje të patundshmërive të eksproprijuar në emër të saj, përfshirë edhe ngastrën kontestuese të shpronësuara sipas Vendimit 07.Nr.465-44/80, dt. 30.05.1980 e cilat në kohën e eksproprijimit është evidentuar në emër të paraardhësit të paditësit.

Me qëllimit të vërtetimit të gjendjes së fundit faktike dhe juridike të ngastrës kontestuese gjykata bëri nxjerrjen e provës me ekspertizë të gjeodezisë të ekspertit A. A. të datës 17.10.2022, është vërtetuar fakti se ngastrat kadastrale nr. 309-0 në sipërfaqe prej S=2624 m<sup>2</sup>, ZK Obiliq, sipas Certifikatës mbi Pronësinë evidentohet në emër të paditësit..

Gjykata, sipas propozimit të palës paditëse, ka bërë nxjerrjen edhe të provës me ekspertizë të bujqësisë me qëllim të vlerësimit të dëmeve që kanë mundur t'i shkaktohen paditësit për shkak të mos-shfrytëzimit të ngastrave kontestuese, konkretisht përcaktimin e llojit të kulturave bujqësore që do mund t'i kishte mbjellë paditësi.

Eksperti i bujqësisë z. A. C. me ekspertizën e bujqësisë të punuar me datë 08.03.2023 ka konstatuar se duke marrë për bazë katalogun e prodhimeve bujqësore si dhe fitimin e pritshëm neto për hektar nga këto prodhime bujqësore, për periudhën kontestuese nga data 01.09.2012 e deri më 2022, për 11 vite, paditësi do të mund të realizonte fitim nga këto të mbjella në shumën prej 4,158.00 euro.

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar andaj e njëjta është refuzuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Deri tek ky vlerësim Gjykata erdhi pasi që se paditësi në këtë procedurë gjyqësore nuk ka arritur të dëshmoj para Gjykatës se e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit për shkak të posedimit të ngastrës kontestuese e cila evidentohen si pronë e paditësit.

Gjykata fillimisht gjeti se e paditura ka hyrë në posedim të ngastrave kontestuese qysh nga viti 1980, dhe atë duke u bazuar në vendimin nr. 07.Nr.465-44/80, dt. 30.05.1980, sipas të cilit vendim, në mesin e ngastrave të dedikuara për shpronësim në emër të paraardhëses së të paditurës KEK kanë qenë edhe pronat që tanimë figurojnë në emër të paditësit. Fakti se e paditura ka shpronësuar ngastrat kadastrale objekt i këtij kontesti dhe ka hyrë në posedim të këtyre pronave përveç që listohet në grupin e fakteve jo kontestuese në këtë çështje gjyqësore, është vërtetuar edhe nga ekspertiza gjeodezike e administruar si provë në këtë shqyrtim gjyqësor, sipas të cilës ekspertizë është vërtetuar edhe fakti se qëllimi për të cilin janë shpronësuar pronat objekt i këtij kontesti është ekzekutuar në tërësi.

Me Nenin 154 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij” ndërsa me nenin 158 të po këtij ligji, është paraparë se: “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.

Gjykata vlerëson se për tu konstatuar faji për dëmin e shkaktuar duhet plotësohen komulativisht këto kushte: a) ekzistenca e dëmit, b) kundërligjshmëria e veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit, dhe d) lidhja kauzale midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur.

Gjykata tutje vë në pah se me Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore i vitit 1980, në fuqi në kohën kur e paditura ka hyrë në posedim të ngastrave kontestuese, nenin 72 të saj përcaktohet se “Posedimi është i ligjshëm po qese mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit”.

Nga provat e administruara është vërtetuar se këtu e paditura është poseduese e ligjshme e ngastrave kontestuese dhe se kjo e drejtë i buron nga Vendimit 07.Nr.465-44/80, dt. 30.05.1980 mbi shpronësimin, i cili vendim nuk është atakuar asnjëherë në procedurë gjyqësore nga paditësi.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, në rastin konkret, Gjykata gjen në veprimet e të paditurës nuk është manifestuar elementi i kundërligjshmërisë, por as i fajësisë e rrjedhimisht nuk është provuar dëmi i shkaktuar si kusht me rëndësi për krijimin e detyrimit për shpërblim, respektivisht përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar tjetrit. Rrjedhimisht, në mungesë të veprimit të kundërligjshëm, mungon edhe lidhja kauzale në mes të shkakut dhe pasojës.

Për më tepër aktvendimi me të cilin paditësi është shpallur trashëgimtarë i pronave kontestuese në vitin 2015 sipas aktit noterial, është nxjerrë pas vendimit të Kuvendit Komunal në Prishtinë të vitit 1980, sipas së cilit është bërë shpronësimi i paluajtshmërive lëndore.

Rrjedhimisht përkundër faktit se paditësi është ai që ende figuron si pronar i ngastrave kadastrale kontestuese, e paditura paraqitet si poseduese e ligjshme e ngastrave kadastrale objekt i këtij kontesti, andaj fakti se e njejta pas vendimit Nr. 07.Nr.465-44/80, dt. 30.05.1980 mbi shpronësimin nuk ka ndërmarrë veprime për bartjen e pronave kontestuese në emër të saj në regjistrat kadastral nuk nënkupton për Gjykatën ekzistencën e dëmit për paditësin.

Gjykata pas analizimit të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë juridike, sa i përket fakteve mbi të cilat paditësi e mbështet kërkesë padinë për kompensim dëmit lidhur me pamundësinë e shfrytëzimit të pronave kontestuese si rezultat i veprimeve të kundërligjshme nga ana e të paditurës. Prandaj gjykata duke u nisur nga të gjitha arsyet e theksuara më lartë, qartë rezulton se në këtë rast mungon baza faktike në të cilën paditësi e mbështetë kërkesë padinë, e në mungesë të së cilës mungon edhe baza juridike për aprovimin e saj, prandaj në kuptim të nenit 319 par.1 dhe nenit 322 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar të vendosur si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoj edhe provat tjera të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, por që të njëjtat nuk patën ndikim për vendosjen ndryshe lidhur më këtë çështje kontestimore.

Vendimin që secila pala t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 450 në lidhje me nenin 452.2 LPK-së.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

## GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1595/2015, datë 21.06.2023

Gjyqtari

---

Përparim Zeka

### UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKIMIMIT:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.